



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Nr. 151 Prot.

Tiranë, më 04.03. 2025

VENDIM

Nr. 96, Datë 07.03.2025

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit (komisioni) në mbledhjen e tij të datës 07.03.2025 ku morën pjesë:

- | | |
|-------------------------|----------|
| - Znj. Arsiola Dyrmishi | Kryetare |
| - Z. Gentjan Thoma | Anëtar |
| - Znj. Anairda Arizaj | Anëtare |
| - Znj. Ersida Teliti | Anëtare |

vijoi shqyrtimin e ankesës së konsumatores O.T. kundrejt subjektit tregtar “Tirana Fashion Shop” (faqe online).

Komisioni pasi dëgjoi informacionin e përgatitur nga Sekretariati teknik dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion të tij,

VËREN SE:

Qendra “Konsumatori Shqiptar” nëpërmjet email-it të datës 14.01.2025, ka përcjellë pranë komisionit ankesës e konsumatores O.T. kundrejt subjektit tregtar “Tirana Fashion Shop” (faqe online).

Ankesa është administruar pranë komisionit me numër protokolli 01, datë 14.01.2025.

Konsumatorja O.T. ka porositur në faqen online të subjektit tregtar “Tirana Fashion Shop” një produkt me vlerë 4,900 lekë, por në momentin e dorëzimit të porosisë subjekti i ka faturuar një vlerë më të lartë prej 5,500 lekë dhe gjithashtu produkti i dërguar nuk përputhej me porosinë e bërë prej saj. Pas marrjes së porosisë dhe evidentimit të mbifaturimit, konsumatorja ka nisur një komunikim të vazhdueshëm për me shumë se një muaj me subjektin tregtar, i cili i ka premtuar rimbursimin e shumës së mbifaturuar (prej 600 lekë) dhe dërgimin e produktit të saktë që përputhej me përkrahimin dhe porosinë e bërë. Pavarësisht premtimeve, nga ana e subjektit tregtar nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim për të zgjidhur situatën.

Në këto kushte, konsumatorja O.T. i është drejtuar Qendrës “Konsumatori Shqiptar”, e cila në vijim e ka përcjellë ankesën pranë Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit nëpërmjet email-it të datës 14.01.2025 (protokolluar pranë komisionit me nr.01, datë 01.01.2025). Ankesa shoqërohet edhe me screenshot të komunikimeve të konsumatores me subjektin tregtar, si dhe me foto të faturës tatimore.

- **Lidhur me kompetencën e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit**

Së pari, subjekti "Tirana Fashion Shop" (NUIS L81527030I) zhvillon aktivitet tregtar nëpërmjet faqes së saj në rrjetin social Instagram.

Në kuptim të përkufizimit të parashikuar nga neni 3, pika 14 e ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve" të ndryshuar, subjekti plotëson kërkesat ligjore për t'u klasifikuar si "tregtar", pasi është subjekt, i cili vepron për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike dhe/ose tregtinë.

Së dyti, çështja është objekt shqyrtimi, pasi konsiston në një marrëdhënie midis tregtarit dhe konsumatorëve dhe rrjedhimisht brenda fushës së zbatimit të ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve" të ndryshuar dhe në kompetencë të Komisionit.

Sa më sipër, Komisioni vlerëson se, shqyrtimi i ankesës së lartpërmendur është në kompetencë të saj.

Bazuar në VKM-në nr.1444, datë 22.10.2008 "Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve", pika 3, shkronja (a) parashikon se:

"3. Komisioni ka përgjegjësinë të shqyrtojë shkeljet e ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, për:
a) praktikat e padrejta tregtare"

- **Vlerësimi i praktikës**

Komisionit i është përcjellë nga Qendra "Konsumatori Shqiptar" ankesa e konsumatores O.T. kundrejt subjektit tregtar "Tirana Fashion Shop" (faqe online). Në mbledhjen e datës 15.01.2025, Komisioni vendosi fillimin e hetimit administrativ për subjektin tregtar "Tirana Fashion Shop" (faqe online). Me anë të shkresës me nr.01/1, datë 31.01.2025 i është bërë me dije subjektit tregtar "Tirana Fashion Shop" (faqe online) se pranë komisionit është përcjellë ankesa e konsumtares së sipërcituar dhe nga ana e komisionit ka filluar hetimi administrativ, si dhe është kërkuar që brenda datës 14 shkurt 2025 të dërgohet një informacion i plotë sqarues dhe dokumentacion si nga shoqëria edhe nga konsumtarorja në lidhje me sa pretendohet prej kësaj të fundit. Shkresa nr.01/1, datë 31.01.2025 i është dërguar subjektit tregtar "Tirana Fashion Shop" dhe Qendrës "Konsumatori Shqiptar" edhe në rrugë elektronike me email-in e datës 04.02.2025.

Komisioni në mbledhjen e datës 07.03.2025, mori në shqyrtim përgjigjet e ardhura në vijim të shkresës së saj nr.01/1, datë 31.01.2025 dhe konkretisht:

- Subjekti tregtar "Tirana Fashion Shop" me email-in e datës 11.02.2025 informon se nga ana e tij do t'i kthehet konsumatores shuma e marrë më tepër prej 600 lekë
- Qendra "Konsumatori Shqiptar" me email-in e datës 25.02.2025 ka konfirmuar se konsumatorja është kompensuar për pjesën e detyrimit të mbetur.

Për sa më sipër, në kushtet kur nga ana e Qendrës "Konsumatori Shqiptar" është konfirmuar se konsumatores i është kthyer shuma e mbifaturuar, komisioni konsideron se mosmarrëveshja është zgjidhur mes palëve dhe nuk ka arsye ligjore për të vijuar më tej procedurën e hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit, mbështetur në nenin 52, të Ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, dhe në pikën 2, të VKM-së nr.1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”,

VENDOSI:

1. Pushimin e hetimit administrativ të nisur kundrejt subjektit tregtar “Tirana Fashion Shop” (faqe online).
2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit.
3. Kundër këtij vendimi keni të drejtë të ankoheni në gjykatën kompetente brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

KRYETARI KOMISIONIT

ARSIOLA DYRMISHI

